

## Licensim

Subjektet fizike/juridike dhe OJF-te per licensim duhet te paraqesin dokumentat si me poshte:

1. Kerkesen per tu pajisue me license (sipas modelit tip).
2. Programet e kurseve qe ofrohen.
3. Vertetimi i regjistrimit si ofruer i formimit profesional ne zyren perkatese te punesimit.
4. Lejen higjeno-sanitare.
5. Vertetimin nga dega perkatese e tatimeve per pagesat e kontributeve shoqerore e shendetsores te personelit kualifikues, per periudhen qe subjekti eshte i licensuar.
6. Ekstrakti I regjistrimit ne QKR ku, ne piken "Fusha e veprimtarise" te jete shprehur si aktivitet formimi profesional per subjektet fizik/juridik ose Vendimi i Gjykates per OJF-te.
7. dokumentat qe vertetojne pronesine ose marrjen me qira te ambjenteve te pershtatshme per kryerjen e aktivitetit si dhe pajisjeve didaktike te nevojshme.
8. Formulari i Vetedeklarimit. (sipas modelit).

Detyrimet e subjektit:

1. Te kete ambjente te pershtatshme, ne menyre te tille qe per cdo vend trajnimi te kete jo me shume se dy kursante.
2. Te kete pajisjet e nevojshme didaktike per kryerjen e aktivitetit.
3. Instruktoret e punesuar duhet te kene arsimin e larte perkates ose arsimin e mesem profesional dhe jo me pak se 2 vjet eksperience pune. Per profesione te vecanta duhet te kene arsimin e mesem dhe te kene kryer kurse afatmesme kualifikimi.
4. Numri i pjesmarresve ne nje kurs nuk mund te jete me i madh se 15.
5. Dokumentat dorezohen ne dy kopje (njera origjinale dhe tjetra fotokopje) dhe depozitohen ne sektorin e protokoll arkives ne Sherbimin Kombetar te Punesimit.
6. Subjekti i licensuar duhet te njoftoj me shkrim zyren perkatese te punesimit per datat e zhvillimit te testeve perfundimtare, te pakten dy jave perpara.
7. Subjekti i licensuar, ne perfundim te kursit, pajis kursantet me Certifikaten perkatese te firmosur dhe vulosur prej tij. Certifikata, ku vendoset numri dhe data e Licenses se leshuar nga Ministria e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, siglohet nga Drejtori i Zyres perkatese te punesimit.
8. Ne fillim te cdo kursi subjekti i licensuar dergon nje liste te kursanteve pjesemarres ne kurs, ne zyren perkatese te punesimit. Gjithashtu ai mban nje regjister amze per regjistrimin e kursanteve dhe nje rregjister per zhvillimin e temave ditore sipas programit, mbarevajtjen e cdo kursi, ku te shenohet prezenca dhe perparimi i kursanteve.
9. Tarifa per dhenien e licenses derdhet ne financen e MPCSSHB dhe eshte 10.000leke dhe ne rastet e ripertesitjes se licenses tarifa eshte 5.000leke.

Detyrimet e Sherbimit Kombetar te Punesimit:

1. Sherbimi Kombetar i Punesimit ben monitorimin e subjekteve, ne bashkepunim me zyren perkatese te punesimit, ne menyre periodike, por jo me pak se dy here ne vit dhe bejne nje raport te shoqeruar me rekomandime te detyrueshme.